



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM TIRANË**

Datë 30.11.2023

NJOFTIM

**PËR FILLIMIN E PROÇEDURËS SË KONKURIMIT
PËR
EMERIMIN NË POZICIONIN E PUNËS PËR NJË VEND
“SEKRETAR/E PRANË PROKUROREVE ”**

Bazuar në Ligjin Nr 97/2016 “ Për Organizimin dhe funksionimi e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë , si dhe mbi bazën e “ Strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me qëllim plotësimin e vendit vakant në zbatim të strukturës së Institucionit, në përmbushje të organikës Nr.54 datë 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm për Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

1. Kërkohet të punësohet 1 (një) punonjës/e me emertese sekretar/e pranë prokuroreve, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me adrese Rr. “ Haxhi.H. Dalliu” Nr 97 Tiranë.

N J O F T O N

1.Fillimin e Proçedurës së konkurimit të hapur të kandidateve për një pozicion me emertese sekretar/e pranë prokuroreve, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë .

2.Referuar neneve 74,75,76 të Ligjit nr 97/2016 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë “,kandidatet e interesuar për konkurim, përveç kushteve të përgjithshme për tu pranuar në punë, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta.

Kandidatët për një pozicion të lire të punës sekretar pranë Prokuroreve duhet të paraqesin kerkesën së bashku me dokumentacionin e meposhtëm :

Kërkesat e Përgjithshme:

1. Të jetë shtetas Shqiptar
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje
6. Ndja tij të mos jetë marrë masë disiplinore në marrëdhënie pune dhe /ose ndonjë masë tjetër disiplinore

Kërkesat e veçanta- prioritet në përzgjedhjen e kandidatëve

1. Të ketë përfunduar arsimin e Lartë Drejtësi Baçelor dhe Mastër Drejtësi (3 + 2)
2. **Të ketë përvojë punë jo me pak se një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me prokurorinë**
3. Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.
4. Të ketë aftësi komunikuese dhe punë në grup.
5. Të ruajë sekretin hetimor.
6. Të njohë Ligjin “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
7. Të ketë njohuri të mira kompjuterike si : Ëord, Excel, Poëer Point etj.
8. Të njohë ligjin “Për Prokurorinë”.
9. Të njohë Rregulloren e Institucionit
10. Të njohë Kodin e Punës dhe atë të Proçedurave Administrative .
11. Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja.
12. **Eksperienca e punës jo me pak se një vit pune me sigurime shoqerore .**

4-Kandidatët për një pozicion të lire të punës “ sekretar pranë prokuroreve“ duhet të paraqesin kërkesën së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm :

- a) Kërkesë për punësim,(inventar të dokumentacionit)
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë e vlefshme.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së lartë Drejtësi Baçelor ,çertifikatë notash të noterizuar, Diplome Mastër, çertifikatë notash dhe çdo diplomë tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar e noterizuar
- e) Dëshmi kualifikimi (nese ka)
- f) Vërtetim përmbartimi gjyqësor
- g) Dokument që verteton praktiken profesionale
- h) Vertetim për gjendjen gjyqesore (Dëshmi penaliteti).
- i) Vërtetim nga Gjykata
- j) Vërtetim nga Prokuroria
- k) Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.
- l)Vërtetim i njësisë administrative
- m)Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore i afte për punë
- n)Vërtetim që nuk ka masë disiplinore

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kandidatit, të paraqitet nga dt. 30.11.2023 ora 8.00 deri në datë 15.12.2023 ora 16.00, në K/sekretarinë e Prokurorisë Pranë gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Rr “ Haxhi.H. Dalliu “ Nr 97 Tiranë .

Konkurimi për vendin e punës në pozicionin “ sekretare pranë prokuroreve” do të zhvillohet në dy faza :

Faza e parë: verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidatet, e cila realizohet nga Kancelari i kësaj Prokurorie me qëllim vlerësimin e dokumentacionit nëse janë plotësuar kriteret e shpallura në njoftim.

Kandidatët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë: Testimi (me shkrim, me gojë).

Kandidatët e kualifikuar i nënshtrohen intervistës së strukturuar me gojë, vlerësimin me shkrim si dhe vlerësimin të jetëshkrimit ku konsiston arsimimi, përvoja e punës, kualifikimet, trajnimet aftësite profesionale .

Totali i pikëve të vlerësimin është 100 pikë të mundshme të cilat ndahen në këtë kategorizim:

Vlerësimi i jetëshkrimit, eksperiencia e trajnimeve etj, 20 pikë

Vlerësimi i testimit me shkrim, 50 pikë

Vlerësimi për intervisten e strukturuar me gojë, 30 pikë

Testimi do të bazohet në kërkesat mbi kriteret e veçanta dhe njohuritë mbi ligjet e specifikuar në të.

Që kandidatët të shpallen fitues duhet të marrin mbi 70 pikë.

5-Vlerësimi i kandidatëve nga komisioni do të bëhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga secili kandidat si dhe rezultati i testimit me shkrim dhe të intervistës me goje me secilin prej tyre.

Testimi dhe Intervista me secilin kandidat, do të kryhet në ambjentet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, salla e mbledhjeve kati 6.

Njoftimi i datës dhe ores së intervistimit për kandidatët e kualifikuar do të bëhet me telefon ose email nga Kancelari.

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË

